



**Republika e Kosovës / Republika Kosova / Republic of Kosova**



**Komuna e Podujevës / Opština Podujevo / Municipality of Podujeva**

## **PROCESVERBALI I DËGJIMIT PUBLIK PËR SEKTORIN E URBANIZIMIT DHE SHËRBIMEVE PUBLIKE**

Dëgjimin publikim e hapi drejtori i drejtorisë për Buxhet dhe Financa, Fatlum Osmani, ku potencoi që këto dëgjime i paraprijnë hartimit të buxhetit.

Drejtori Osmani tha se buxheti i komunës së Podujevës për vitin 2023-2025 ka rritje të mirë ku në bazë të Qarkores Buxhetore të cilën e ka sjellë Ministria e Financave, buxheti për vitin 2023 do të jetë mbi 27 mil. euro, që do të thotë është rreth 4 mil euro më i madh sesa buxheti i vitit 2022 dhe kjo rritje do të jetë progresive edhe në vitet e ardhshme, ku deri në vitin 2025 do të arrijë vlera mbi 30mil euro.

Në bazë të planfikimeve tona do të kemi rritje në të gjitha kategoritë buxhetore duke përfshirë kategorinë e mallrave, të subevncioneve dhe investimeve kapitale. Në subvencione do të kemi mbi 1mil euro, në kategorinë e investimeve kapitale afërsisht do të kemi rritje rreth 2 mil euro, gjithashtu kemi rritje edhe në kategorinë e mallrave në mënyrë që të plotësohen nevojat e sektoreve të ndryshme në komunën e Podujevës.

Sot do të diskutojmë për investimet kapitale të sektorit të urbanizimit dhe shërbimeve publike, si dhe investimet e nevojshme në lokalitetet e juaja. Sa i përket buxheti të vitit 2022, periudha e parë kryesisht shërben për procedura të prokurimit, mirëpo pjesa e dytë e vitit, muaji korrik, gusht dhe shtator do të jenë vlugu i madh i investimeve kapitale.

Në planifikimet tona që ende nuk janë finale, parashihen investime kapitale në cdo sector dhe në cdo lokalitet, kemi investime të mëdha në qytet si rikonstrukturimi i rrugës “Skënderbeu”, gjithashtu rruga “Xhemajl Mustafa”, vazhdimi i rrugës së Xhamisë që lidhet me magjistrale, gjithashtu në projeksionet tona është edhe ndërtimi i unazës së qytetit me rrugët lidhëse të qytetit, trajtimi i ujërave të zeza ka një vëmendje të vecantë në investimet të cilat janë të planfikuar në vitin 2023-2025, ku rreth 2 mil euro parashihen në trajtimin e ujërave të zeza, ku më këto investime mendojmë të rumbllaksojmë tematikën e problemit më ujëra të zeza. Gjithashtu investime të tjera në fushën e shërbimeve publike sic është; rregullimi i shtretërve të lumenjëve dhe ndriçimet publike, rrugët me zhavor, urat mbrojtëse etj.

Drejtor i drejtorisë së Planfikimit Urban dhe Mbrojtje të Mjedisit, Leotrim Krasniqi, bën disa prezantime sa i përket projeteve te drejtorisë se urbanizimit ku thekson;

Asfaltimin e rrugës kryesore të rrugës “Skënderbeu”, rrugën “Xhemajl Mustafa”, gjithashtu rrugën lidhëse që është prej rrugës “Vllëzërit Frashëri” me magjistralen Prishtinë-Podujevë që është planifikuar këtë vit, mirëpo një pjesë e buxhetit do të ndahet edhe vitin e ardhshëm, dhe rrugët lidhëse “Shaban Shala” me “28 Nëntori”. Në qytet poashtu Krasniqi thotë se i është kushtuar rëndësi edhe zgjerimit të rrugëve dhe asfaltimit të rrugëve me rreth gjysë milionë euro.

Përpos kësaj është paraparë po ashtu edhe zgjerimi i paraqeve, mirëmbajtjes së tyre, tha drejtori Krasniqi.

Florim Mucolli- përfaqësues i fshatit Herticë, kërkesa jonë është për projektin e ujit, projekti edhe pse ka kalu fazën e prokurimit ka ngecur si projekt, çështje tjerat janë rrugët që sështë bërë sa duhet, psh rruga mbi 2 km, lagja e Bajgorëve, që e lidh me shkollën e Sudullit, dhe rruga tjetër që lidh lagjën e Mucollëve deri te Lagjia Bislimi që jetojnë dy familje në pikën kufitare, gjithashtu subvencionimi i Ojq nuk është në nivel të knaqshëm.

Ruzhdi Fazliu- përfaqësues i fshatit Dumnicë e Epërme, pyet se a ka ndonjë projekt për fshatin tonë, shfaqë pakënaqësi për mos investim në fshatin e tij.

Liridon Dema - shitës ambulant, shfaq pakënaqësi për largimin e tyre, kërkon zgjidhje afatgjate për shkak se kushtet ekonomike janë të rënduara.

Osman Bahtiri- përfaqësues i fshatit Gllamnik, fshati ynë si më i madhi në Podujevë, ka disa kërkesa; vazhdimi i rrugëve të pa përfunduara, të asfaltohet rruga që lidh fshatin Gllamnik me Sfeqël dhe Dumosh, shtrimi i disa rrugëve me zhavor, lagjia e Cubollëve. Të ndërtohet një sallë e edukatës fizike, kanalizimet janë disa pjesë të pa përfundura në lagjen Zhegrova, Kosumi si dhe në lagjen Zenolli dhe Toska, Syla, pastaj kemi edhe ndërtimi e trotuarit të mbetura nga viti i kaluar si dhe ndriqimi t’i përfshin edhe disa lagje.

Rexhep Dauti- përfaqësues i fshatit Llaushë, që nga viti i kaluar i kemi dy kërkesa për fshatin tonë si rruga, “Avdyll Dushkollli” e cila bën lidhjen e dy fshatrave, si dhe rruga që lidh dy shkollat e Llaushës që është rreth 600 metra, është e pakalushme.

Ibrahim Jusufi - fshati Dumnicë e Epërme, potencoi se në fshatin Dumnicë, rruga në mallahën e tij nuk është e ndërtuar, janë 15 familje, janë pothuajse në pikën kufitare, mundësisht rruga të rregullohet edhe të lidhet me fshat. Problem tjetër është rryma e dobët, shtyllat elektrike të vjetra.

Osman Syla-përfaqësues i fshatit Llapashticë e Poshtme, kërkesat tona për fshat janë, asfaltimi në mes të fshatit ku jetojnë 5 familje, rruga tjetër për zhavor është rruga Potera deri te përmendroja e “Bedri Ahmetit”, rruga tjetër kah varrezat që lidh fshatin me Gllamnikun është në gjendje shumë të keqe.

Fahri Gërguri- nga fshati Siboc i Poshtëm, kërkesat tona janë të kahmotshme që lumi ka ardh deri në Siboc por pastaj është ndërpre, lumi na bën problem shumë të mëdha, ndriqimi ka ardh në

fshat tonin por ka ngel, trotuare tek ne nuk janë rregulluar asnjëherë, si dhe rruga për tri varrezat e fshatit janë rreth 150 metra.

Fadil Berisha- përfaqësues i fshatit Konushec, kërkesat e fshatit tonë janë problemet me ujin e pijes, nuk kemi pjesa kryesore e fshatit, kërkesë tjetër është shtrimi i disa rrugëve me asfalt dhe zhavor, si dhe vazhdimi i trotuareve.

Përfaqësuesi i fshatit Dumosh, kemi disa ankesa për rrugën kryesore, që disa qytetarë të pandërgjegjshëm e dëmtojnë asfaltin dhe nuk e rregullojnë më, gjithmonë për shkak të nevojave tyre personale, ankesa tjetër është trotuari është shumë i ngushtë për nxënësit afër shkollës.

Dy rrugë lidhëse prej Dumoshi në fshatra janë të pa rregullume që lidhin me fshatin Sfeqël dhe fshatin Barainë. Sa i përket ujit nuk kemi tërë ditën, na duhet vazhdimisht me hap puse dhe me ble ujë.

Fahrudin Mahmuti-përfaqësues i fshatit Siboc i Epërm, kërkesa jonë e parë është ura e fshatit, që është duke u dëmtuar shumë, kemi një rrugë mjaftë të ngushtë e cila rrezikon banorët që ecin, ka nevojë të ndërtohet trotuar aty.

Ramadan Muciqi - Llapashticë e Epërme, kemi nevojë të asfaltohen disa rrugica, kemi kërkesë edhe për ndriçim, problem kemi me ujin e pijshem sepse uji i puseve nuk është i përdorshëm, të rregullohen ujësjellësi në fshatin tonë.

Një qytetar tjetër nga Merdari potencon problemin me ujë të pijës, rreth 4 vite kanë mungesë të ujit të pijes. Kërkon zgjidhje për gjithë qytetarët si kërkesë elementare.

Drejtori Osmani i falëndëron të gjithë për propozimet, sygjerimet dhe kritikrat, duke theksuar se është i hapur deri në hartimin e buxhetit për gjitha prioritetet e qytetarëve.

Osmani theksoi se tek sektori i bujqësisë kemi rritje shumë të theksume ku nga 400 mijë në vitin e ardhshëm do të jenë 700 mijë, kemi rritje edhe ne fushën shëndetësisë sa i përket subvencionimit për kategorinë e personave që vujnë nga sëmundjet e rënda kronike, gjithashtu subvencionimi në fushën e sportit dhe kulturës do të ketë rritje të konsiderushme.

Sa i përket investimeve në infrastrukturën rrugore kemi planifikuar që të përfshijmë të gjitha vendet, edhe tek problematikat e ujërave të zeza dhe ujit të pijes kemi planifikime ku kemi rritje enorme të fondeve që i përket planifikimit të ujërave të zeza ku i bie mbi 2 mil euro, dhe me këto fonde do të zgjidhen përfundimisht problemet me ujëra të zeza.

Cështja e ujësjellësit është kompetencë e “KRU” Prishtina, ne jemi në kontakte të vazhdueshme, edhe pse nuk është në kompetencën e komunës ne kemi planifikuar mbi 1 mil euro për riparimin e rrjetit të ujësjellësit. Ndërsa rregullimi i rrugëve me asfaltim dhe zhavor do të fillojnë së shpejti gjate 6 mujorit të dytë.

Drejtori i Urbanizmit, Krasniqi tha se për Herticë janë paraparë disa rrugë për asfaltim si arterie kryesore që janë, pastaj njëjtë edhe për fshatin Dumnicë tha se kemi planifikuar asfaltimin e disa rrugëve për 2023, për fshatin Gllamnik është e paraparë që pothuajse cdo rrugë është e përfshirë të përfundohet, në fshatin Llaushë gjithashtu kemi planifikim te asfaltimit të disa rrugëve.

Kërkesat tjera nga Siboci, Dumoshi, Llapashticën janë pothuajse të planifikuara të përfundohen në 2023.

Dëgjimi publik është transmetuar në ueb faqen zyrtare si dhe rrjetin social facebook.

Në vegëzën e mëposhtme mund të gjeni transmetimin e dëgjimit publik.

<https://www.facebook.com/KomunaEPodujeves/videos/852707352366729/>

**Podujevë 08.07.2022**